



BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK
SEKRETARI

Nr. 2299 Prot.

Rrëshen më, 22. 06. 2023.

Lënda : Thirrja e Mbledhjes së Parë të Këshillit Bashkisë Mirditë (Konstituimi).

I / E nderuar Z/Znj. _____ (Këshilltar i mandatuar nga KQZ).

Adresa ; _____,

Mirditë.

Në mbështetje të nenit 48, pika 2, neni 60, pikat 1, 3 dhe 4, e ligjit nr. 139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", Rregullores së Funkcionimit të Këshillit Bashkisë, ju njoftoj se ditën e **Martë**, datë **27. 06. 2023**, ora **10⁰⁰**, në Pallatin e Kulturës Rrëshen (te salla e koncerteve), do të zhvillohet mbledhja e Parë e këshillit të bashkisë Mirditë, me këtë **rend dite**:

1. Fjala e hapjes dhe përshendetja, nga sekretari i këshillit.
2. **Konstituimi i Këshillit të Bashkisë.**
 - a) Zgjedhja e Komisionit të Mandateve;
 - b) Verifikimi dhe miratimi i mandateve të anëtarëve të këshillit;
 - c) Betimi i këshilltarëve.
3. **Zgjedhja e Kryetarit të Këshillit.**
 - a) Propozim dhe prezantim i shkurtër i kandidatëve;
 - b) Zgjedhja e komisionit të votimit, si rregull 3 anëtar;
 - c) Përgatitja dhe procedurat e votimit;
 - d) Shpallja e rezultateve të votimit dhe zgjedhja e kryetarit të këshillit bashkisë,
4. **Zgjedhja e 2 Zv.kryetarëve të këshillit bashkiak, (1 nga opazita dhe 1 nga shumica);**
 - a) Propozim dhe prezantim i shkurtër i kandidatëve;
 - b) Përgatitja dhe procedurat e votimit;

- c) Shpallja e rezultateve të votimit dhe zgjedhja e zëvendëskryetarëve të këshillit bashkisë,
- 5. Cermonia e marrjes së dorëzimit të detyrës së Kryetarit të Bashkisë.**
- a) Deklarimi i vlefshmërisë së mandatit të kryetarit të bashkisë;
- b) Betimit i Kryetarit të Bashkisë dhe nënshkrimi i aktit të betimit;
- c) Fjala përshendetëse e Kryetarit të Bashkisë.
- 6. Zgjedhja e këshilltarëve që do të përfaqësojnë, Këshillin e Bashkisë Mirditë në Këshillin e Qarkut Lezhë.**

Bashkëlidhur rendit të ditës, Vendimi nr. 574, datë 24.5.2023, i Komisionerit Shtetëror i Zgjedhjeve, “Për shpërndarjen e mandateve ndërmjet subjekteve zgjedhore, në këshillin e bashkisë Mirditë, për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 14 Maj 2023”.

Duke ju falenderuar.



SEKRETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Gaspër TOPOLLAJ